

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“Licencimi, mirëmbajtjen dhe trajnimin e programeve inxhinierike në OST sh.a.”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

72212218-0 - Shërbim për krijim programesh për menaxhim licensash

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

49,000,000 (dyzet e nëntë milion) Lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën 436,020 (katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëzet) Euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 18.05.2023 (1 EUR = 112.38 ALL).

**Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:**

Procedura e prokurimit me objekt “Licencimi, mirëmbajtjen dhe trajnimin e programeve inxhinierike në OST sh.a.”, ka për qëllim rritjen e cilësisë së punës të OST sh.a. dhe krijimin e licencimit të disa programeve inxhinierike që përdoren nga Autoritetit Kontraktor, sipas standardeve më të fundit të tregut. Gjithashtu pjesë e kësaj procedure prokurimi është edhe trajnimi i punonjësve me programet e reja që do të sigurohen nga Kontraktori.

Për këtë arsye, ndarja e kësaj procedure në Lote dhe rrjedhimisht mundësia e lidhjes së kontratës me disa operatorë ekonomikë të ndryshëm, do të vështirësonte realizimin e kontratës, pasi operatorët ekonomikë të ndryshëm mund të paraqiten me oferta të cilat nuk përputhen me njëra-tjetrën, me qëllim mirëmbajtjen dhe konfigurimet përkatëse të kërkuara për këtë procedurë.

Autoriteti Kontraktor është institucion i rëndësishëm në sistemin elektro-energjitik shqiptar dhe cdo vonesë në realizimin e kontratës mund të shkaktojë dëme të mëdha në rrjetin e transmetimit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “**Operatori i Sistemit të Transmetimit**” (OST) sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

*2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 98,000,000 (nentedhjete e tete milion) Leke.*

*Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

*Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e shërbimeve objekt procedure prokurimi, kërkohej që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta

realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlere e xhiros te jete ne masen 98,000,000 (nentedhjete e tete milion) Leke.

---

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 19,000,000 (nentedhjete milion) Lekë pa TVSH.*

*Lidhur me kete pike:*

*Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlere, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e sherbimeve të furnizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e sherbimeve të furnizuara.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa afersisht 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate sasine dhe cilesine e sherbimeve objekt procedure prokurimi, eshte menduar se vlere e kerkuar qe OE ofertues te kete bere me kontrata te ngjashme, te jete afer limitit maksimal dhe ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

---

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO-ve, (te perkthyer ne shqip dhe te noterizuar) te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:*

✓ **ISO 9001:** për menaxhimin e cilësisë

- ✓ *ISO 27001: për menaxhimin të sigurisë së informacionit*
- ✓ *ISO 20000-1: për sistemet e menaxhimit të shërbimit*

**Argumentimi:** Në lidhje me kërkesën që OE duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e standardeve, është menduar se ky është një kriter i nevojshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në proporcion me të, me qëllim për të vertetuar cilësinë e shërbimit dhe garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas Standardeve Ndërkombëtare të objektit të kontratës. Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 30 të VKM Nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

**Certifikata për menaxhimin e cilësisë ISO 9001:** është referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë permasave. Ky kriter kërket nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

**Certifikata e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001:** është e nevojshme pasi përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të sigurisë së informacionit, për shkak të rëndësisë së veçantë që ka AK në Republikën e Shqipërisë, posaçërisht në sistemin elektro-energjetik, gjykohet se informacioni duhet mbrojtur nga Kontraktori. Certifikimi sipas kësaj kategorie konfirmon ekzistencën dhe funksionimin e kontrolleve të OE ofertues dhe i jep sigurinë e nevojshme AK.

**Certifikata për sistemin e menaxhimit të shërbimit ISO 20000-1:** është e nevojshme si kriter kualifikues, lidhet me natyrën e kontratës. Kjo kategori certifikimi garanton AK-ne, që investimi objekt kontrate do të realizohet nga ofertues që zotërojnë dhe ofrojnë kapacitete profesionale të cilat garantojnë realizimin me sukses dhe me cilësi, të specifikave të objektit të kontratës, sipas standardeve ndërkombëtare.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues për kryerjen e këtij shërbimi duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve jo më të vogël se 10 (dhjetë). Të paktën 7 prej tyre duhet të jenë të diplomuar në shkencat elektronike / teknologji informacioni / informatike / informatike ekonomike / mekatronike / telekomunikacion. Punonjësit duhet të disponohen nga Operatori Ekonomik ofertues për një periudhë prej të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe të jenë të certifikuar si më poshtë:*

- ✓ *Për të garantuar një menaxhim sa më të mirë të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) person të certifikuar për Menaxhimin e Projektit (PMP ose ekuivalent). Certifikimi duhet të vertetohet lehtësisht nga website zyrtar i certifikuesit.*
- ✓ *Për të garantuar implementimin dhe menaxhimin e sistemeve përfshirë implementimin sipas praktikave më të mira të sigurisë së informacionit, operatori ekonomik duhet të*

- kete te pakten 1(nje) punonjes te certifikuar per Implementimin dhe Menaxhimin e Sistemeve te Sigurise se Informacionit (CISM ose ekuivalent). Certifikimi duhet te vertetohet lehtesisht nga website zyrtar i certifikuesit.*
- ✓ *Per te garantuar implementimin dhe testimin e sistemeve te informacionit, operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1(nje) person te certifikuar si analizues testimi te sistemeve (Certified Software Testing Analyst ose ekuivalent). Certifikimi duhet te vertetohet lehtesisht nga website zyrtar i certifikuesit.*
  - ✓ *Per te garantuar implementimin dhe menaxhimin e sistemeve te informacionit, operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1(nje) person te certifikuar si Menaxher i sistemeve IT (ITIL ose ekuivalent). Certifikimi duhet te vertetohet lehtesisht nga website zyrtar i certifikuesit.*
  - ✓ *Per te garantuar autenticitetin dhe disponueshmerine e sistemeve te implementuara te konunikimit dhe ne menaxhimin e disponueshmerine, operatori ekonomik duhet te kete te pakten 2(dy) punonjes te certifikuar per Komunikim ne rrjeta online (CCNA ose ekuivalent).*
  - ✓ *Per te garantuar implementimin e sistemeve te informacionit te ofruar, operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1(nje) punonjes te certifikuar si Auditor i Sistemeve te Informacionit (CISA ose ekuivalent).*

**Shenim:** *Nje punonjes mund te zoteroje me shume se nje certifikim te kerkuar si me sipër.*

*Per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, per te gjithë stafin e kerkuar me sipër, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: CV-të, listepagesat e-Sig per periudhen e kerkuar, diplomat dhe certifikatat qe vertetojne se punonjesi i disponon aftesite profesionale te tij ne perputhje me kerkesat e lartpermendura.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Kërkesa për punonjesit e sipërpërmendur është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe me aftësitë zbatuese të ofertuesit. Ky kriter respekton parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë e mundur të plotësohet nga cdo OE që ka në objektin e tij tregtar këtë natyrë shërbimi. Kjo kërkesë për kualifikimin e nevojshëm profesionale është në përputhje me Nenin 41 “Kontrata e shërbimeve“ të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.4 *Ne funksion te plotesimit te Shtojces 9 "Formulari permbledhes i vetedeklarimit" Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortakët e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.*

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik".*